



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

### KRYETARI I KOMUNËS

Në mbështetje të nenit 58 pika h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të dates 4 qershor 2008 dhe nenit 40 shkronja h.) të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të dates 26.09.2008, Kryetari i Komunes, kërkon nga Kuvendi i Komunës:

Që duke u bazuar në dispozitat e nenit 12 dhe 17 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e dates 4 qershor 2008, Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet publike, nenit 6 të Ligjit Nr.04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, nenit 4 pika 1 dhe nenit 5 të Rregullores Nr.02/2013 mbi kriteret për krijimin e ndërmarrjeve publike lokale dhe pjesëmarrjen e komunave në Bordin e drejtorëve të ndërmarrjeve rajonale të ujit si dhe neneve 9 dhe 20 par.20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të dates 26.09.2008, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e datës \_\_\_\_\_ 2021, të miratojë këtë:

### PROPOZIM

### V E N D I M PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR KRIJIMIN E NDËRMARRJES PUBLIKE LOKALE "ULPIANA" SH.A

#### Neni 1

Me këtë Vendim fillon procedurat për krijimin e Ndërmarrjes publike lokale "Ulpiana" sh.a me seli në Lipjan.

#### Neni 2

N.P.L "Ulpiana" sh.a do të jetë shoqëri aksionare në pronësi të Komunës së Lipjanit dhe do të jetë kompetente për kryerjen e detyrave dhe punëve në vijim:

- 1.Menaxhimin dhe mirëmbajtjen e hapësirave publike komunale,
- 2.Mirëmbajtjen e shesheve publike, parqeve varrezave të qytetit dhe varrezat e dëshmorëve, martirëve, lapidarëve, përmendoreve, pllakave përkujtimore të cilat menaxhohen nga komuna.
- 3.Menaxhimin dhe mirëmbajtjen e objekteve publike të institucioneve të komunës.
- 4.Sigurimin fizik të objekteve të institucioneve të Komunës
5. Menaxhimin dhe mirëmbajtjen e vendparkingjeve publike
6. Menaxhimin e shërbimit me auto merimangë

- 7.Mirëmbajtjen e tregut të gjelbër
- 8.Mirëmbajtjen e ndriçimit publik
- 9.Dekorimin e qytetit në ditët e festave
- 10.Mirëmbajtjen e oxhaqeve të ekonomive familjare dhe objekteve tjera
- 11.Mirëmbajtjen e kanalizimit atmosferik
- 12.Transportimin e kafshëve të ngordhura deri në lokacionin e destinuar për groposjen e tyre
13. Mirëmbajtjen e objekteve banesore dhe ashensorëve

### Neni 3

Pas hyrjes në fuqi të këtij Vendimi Kryetari i Komunës autorizon zyrtarët përgjegjës komunal të cilët në bashkëpunim me drejtoratet kompetente komunale do të vazhdojnë procedurat për kompletimin e dokumentacionit të nevojshëm sipas kritereve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi për krijimin e Ndërmarrjes Publike Lokale "Ulpiana".

### Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen: Zyra e Kryetarit të Komunës, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, Drejtorati për Shërbime Publike, Drejtorati për Zhvillim Ekonomik, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport për ndërmarrjen e të gjitha veprimeve të nevojshme në vijim që kërkohen konform legjislacionit në fuqi.

### Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës .

### Arsyetim

Baza ligjore për miratimin e këtij Propozim-Vendimi është e përcaktuar me dispozitat e nenit 12 dhe 17 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e dates 4 qershor 2008, Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, nenit 6 të Ligjit Nr.04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, nenit 4 pika 1 dhe nenit 5 të Rregullores Nr.02/2013 mbi kriteret për krijimin e ndërmarrjeve publike lokale dhe pjesëmarrjen e komunave në Bordin e drejtorëve të ndërmarrjeve rajonale të ujit si dhe neneve 9 dhe 20 par.20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të dates 26.09.2008 .

Me këtë propozim Vendim fillohen procedurat për krijimin e ndërmarrjes publike lokale "Ulpiana" në Lipjan ndërsa pas hyrjes në fuqi të këtij Vendimi Kryetari i Komunës autorizon zyrtarët përgjegjës komunal të cilët në bashkëpunim me drejtoratet kompetente komunale do të vazhdojnë procedurat për kompletimin e dokumentacionit të nevojshëm sipas kritereve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi për themelimin e Ndërmarrjes Publike Lokale "Ulpiana".

Nga të cekurat më lartë, kërkojmë nga Kuvendi i Komunës miratimin e këtij Propozim-Vendimi.

1Nr. 1-463-18614  
Lipjan, më 8.04.2021

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

